

**V E N D I M**

**“NË EMËR TË REPUBLIKËS”**

**Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tirane e përbërë nga :**

**GJYQTAR : ARTAN GJERMËNI**

Asistuar prej sekretares gjyqesore Ornela Balla, sot me datë 23.04.2018 mori në shqyrtim ne séance gjyqesore, me gjykimi të shkurtuar, çështjen penale me Nr. 1600 Akti që i përket;

**KËRKUESE:**Prokuroria pranë Gjykatës se Rrethit Gjyqësor Tirane , perfaqesuar nga prokurori Artan Lulaj.

**NDAJ TË PANDEHURIT:**Hasan Bara-i biri i Shqir dhe i Fatime, i dtl.07.11.1962, lindur në Dibër dhe banues në Tiranë, Rr “Zanave”, banesa private nr.10 Kamëz, me arsim të lartë, i martuar, i padënuar, me kombësi dhe shtetësi shqiptare, hetuar me masë sigurimi “detyrim paraqitje në policinë gjyqësore”,në mungesë vullnetare, mbrojtur nga Av.Përparim Noka ,me nr. 1232 license dhe NIPT K78408901J, anetare i Dhomes se Avokatise Tirane ,I zgjedhur nga i pandehuri.

**I AKUZUAR:**Për kryerjen e vepres penale “Drejtimit i automjeteve në mënyre të parregullt ’, të parashikuar nga neni 291 te K.Penal .

Gjykata pasi dëgjoi pretendimet e palëve dhe mori provat e nevojshme, degjoi përfundimisht palët qe kërkuan:

**Prokurorin Artan Lulaj:**

-Deklarimin fajtor te te pandehurit Hasan Bara per vepren penale “Drejtimit i automjeteve ne menyre te parregullt ” te parashikuar nga neni 291 i K.Penal,denimin e tij me 1(nje)muaj burgim.

-Ne aplikim te nenit 406 te K.Pr.Penale ,uljen e 1/3 se denimit dhe denimin e tij përfundimisht me 20(njezet) dite burgim.

-Ne aplikim te nenit 63,pezullimin e ekzekutimit te vendimit me burgim ,dhe detyrimin per kryerjen e nje pune ne interes publik prej 40 ore.

-Shpenzimet procedurale dhe ato gjyqesore ne ngarkim te te pandehurit.

-Avokati tha:Aplikim e nenit 63 te K.Pr.Penale dhe detyrimin e te pandehurit per kryerjen e nje pune ne interes publik.

## V Ë R E N:

Pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tirane, nga ana e organit të akuzës, është paraqitur kërkesa për gjykim kundër të pandehurit Hasan Bara i akuzuar për veprën penale "Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt", të parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal.

Nga aktet e seances paraprake rezultojnë, i pandehuri, në mungesë, nëpërmjet mbrojtësit të tij, në bazë të neneve 332/c dhe 403 të K.Pr.Penale ka kërkuar që të procedohej ndaj tij me gjykim të shkurtuar, duke çmuar se çështja mund të zgjidhet në gjendjen që janë aktet.

Në lidhje me kërkesën për gjykim të shkurtuar parashtruar nga mbrojtësi i të pandehurit Gjykata, bazuar në nenin 403 të K.Pr.Penale, vlerëson se e drejta për të kërkuar procedimin me gjykim të shkurtuar i rezervohet në rradhë të parë personalisht të pandehurit, por edhe mbrojtësit të tij të posaçëm. Në këto kushte, gjykata bazuar në nenin 405 të K.Pr.Penale, pasi u njoh me aktet hetimore, vendosi të procedojë me gjykim të shkurtuar, duke çmuar për zgjidhjen e çështjes penale në gjendjen që janë paraqitur aktet nga Organi i Prokurorisë, pasi nga palët nuk pati pretendime pavlefshmërie, papërdoshmërie, për aktet si dhe të tjera kërkesa paraprake të kësaj natyre.

Gjykata, në respektim të dispozitave ligjore (nenin 405 të K.Pr.Penale), duke vlerësuar se aktet janë të plota dhe se çështja mund të zgjidhet në gjendjen në të cilat ndodhen këto akte, vendosi zhvillimin e gjykimit të shkurtuar, duke pranuar kërkesën e bërë nga i pandehuri. Në mbështetje të dispozitave të posaçme procedurale si dhe të Vendimit Unifikues Nr.2, datë 29.01.2003 të Kolegjeve të Bashkuara, ky lloj gjykimi i posaçëm eviton marrjen e provave në seancë gjyqësore dhe debatin lidhur me to. Në këto kushte fashikulli (dosja) e prokurorit kthehet në dosje gjyqësore duke marrë vlerën e provës pas pranimit të kërkesës për gjykim të shkurtuar. Në këtë fashikull bazohen diskutimet përfundimtare të palëve si dhe gjykata në dhënien e vendimit.

Nga verifikimi në tërësi i akteve, rezultojnë se: Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në datë 14.12.2017 ka rregjistruar procedimin penal Nr.10094, në ngarkim të shtetasit Hasan Bara, dyshuar për kryerjen e veprës penale të "Drejtim mjeti në mënyrë të parregullt" parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal. Rezultojnë se, më dt.13.12.2017 rreth orës 18:00, shtetasi Hasan Bara, ka shkuar për të marrë autoveturën e tij, të cilën e kishte parkuar në rrugën që lidh dy rrugët kryesore "Haxhi Hysen Dalliu" me rrugën "Jordan Misja", ose burgut 313. Në këtë rrugë për shkak të ngushticës së saj, ka qenë i detyruar që të manovronte për të hapur rrugën një mjeti tjetër, tip furgon. Gjatë manovrimit, shtetasi Hasan Bara ka goditur një mjet tjetër, duke i shkaktuar disa dëmtime. Për këtë shkak ka dalë nga mjeti dhe ka filluar të diskutojë me pronarin e mjetit tjetër, duke kërkuar mirëkuptimin e tij. Por, pronari mjetit tjetër ka zënë rrugën dhe ka njoftuar punonjësit e policisë.

Pas marrjes njoftim, OPGJ kanë shkuar vendngjarje, të cilët kanë bërë shoqërimin e shtetasit Hasan Bara, pranë Komisarariatit të Policisë nr.3 Tiranë. Pas shoqërimit shtetasi Hasan Bara i është nënshtuar testit të alkolit me aparat "Drager". Nga ky testim rezultojnë se shtetasi Hasan Bara, kishte konsumuar alkool në masën



0.72%, mbi kufirin e përcaktuar nga ligji, për përgjegjësi penale. Ky i fundit, i pyetur nga OPGJ e ka pranuar faktin dhe ka shprehur pendim.

Në këto kushte, shtetasi Hasan bara është arrestuar në flagrancë, i dyshuar për kryerjen e veprës penale të “Drejtimin të automjeteve në mënyrë të parregullt”, parashikuar nga neni 291 i KP. Me vendimin nr.2789, dt.15.12.2017 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vlerësuar të ligjshëm arrestin në flagrancë dhe ka caktuar si masë sigurimi atë të “Detyrimit për tu paraqit në policine gjyqësore”.

**Këto rrethana provohen me:**

**Aktet e fashikullit te hetimit te Prokurorise se Rrethit Gjyqesore Nr.10094 e vitit 2017. Dosja gjyqesore Nr.1690 Akti date 21.03.2018 .**

-Përsa mësipër nga akuza u kërkuar deklarimi fajtor i të pandehurit Hasan Bara për kryerjen e veprës penale “Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt” të parashikuar nga neni 291 te Kodit Penal dhe denimi i tij ne masen e percaktuar ne pjesen hyrese te ketij vendimi, duke u parashtruar se me veprimet e tij kryera me dashje i pandehuri ka konsumuar elementet e vepres penale te parashikuar nga neni 291 te K.Penal.

-Arsyetimi i Gjykes, argumentat juridike, interpretimi dispozitive penale, analiza e provave.

Në këto rrethana, e ndodhur përpara këtyre parashtrimeve, percaktimit te faktit dhe provave në gjykim, Gjykata çmon se veprimet e të pandehurit Hasan Bara plotesojne të gjithë elementet që kërkon legjislacioni penal shqiptar për t’i cilësuar këto veprime si elementë të figurës së veprës penale të “Drejtimi i automjeteve ne menyre te parregullt” parashikuar nga neni 291 te Kodit Penal.

**Në nenin 184 te Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë sanksionohet:**

**1.Eshtë i ndaluar drejtimi i mjeteve ne gjendje të dehur , si pasoje e perdorimit te pijeve alkolike.**

**2.Eshtë i ndaluar drejtimi i mjeteve pas përdorimit të pijeve alkolike dhe nën ndikimin e alkolit.....”**

**Neni 291 i K.Penal sanksionon :**

**“-Drejtimi i automjeteve apo mjeteve të tjera të motorizuara në gjendje të dehur, nën efektin e lëndëve narkotike apo pa dëshminë përkatëse të aftësisë dënohet me burgim nga dhjetë ditë deri në tre vjet.**

**- Gjykata mund të vendosë zëvendësimin e dënimit me burgim me pagimin e një shume të hollash në favor të shtetit.””**

Për të vlerësuar përgjegjësine penale të të pandehurit në lidhje me veprën penale "Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt" të parashikuar nga neni 291 të Kodit Penal, gjykata çmon të nevojshme të analizoje si me poshte vijon.

-Me veprimet e tij të kundraligjshme i pandehuri Hasan Bara duke qene i përgjegjshëm para ligjit, me dashje ka kryer veprimet e paligjshme, duke cenuar kështu marrëdhëniet juridike të vendosura për të garantuar sigurimin e qarkullimit rrugor.

-Nga pikepamja e anës objektive i pandehuri me veprime të kundraligjshme ka konsumuar elementet e anës objektive të vepres penale "Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt" parashikuar nga neni 291 të Kodit Penal, pasi i pandehuri ka drejtuar automjetin nën efektim të pijeve alkoolike.

Për arsyet e lartpërmendura, gjykata vlerëson se akuza në ngarkim të të pandehurit, rezultoi e provuar.

Gjykata në caktimin e llojit dhe masës së dënimit, për të përmbushur qëllimet për të cilat dënimi penal jepet, duke bërë të nevojshme që nëpërmjet dënimeve penale, të behet e mundur lufta parandaluese, mban parasysh rrezikshmerine e vepres, të autorit, shkallën e fajit.

-Në lidhje me llojin dhe masën e dënimit.

Në lidhje me dënimin e të pandehurit Hasan Bara, gjykata vëren se, lloji i dënimit për veprën penale të kryer nga i pandehuri përcaktohet nga vetë ligji, neni 291 i K.Penal i cili parashikon: "...dënohet me burgim nga dhjetë ditë deri në tre vjet.". Kjo dispozitë, siç shihet, ka përcaktuar një lloj dënimi, atë me burgim.

Për sa i përket masës së dënimit, gjykata mban parasysh:

1. Rrezikshmërinë e veprës penale të kryer nga i pandehuri dhe të pasojës së saj. Në këtë kuadër gjykata vëren se vepra penale "Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt" është parashikuar në K.Penal si krim dhe jo si kundravajtje, gjë që tregon çmimin që legjislatori i ka bërë rrezikshmërisë së kësaj vepre. Gjithashtu, gjykata mban parasysh marrëdhëniet juridike që kjo vepër prek ose cënon, që janë marrëdhëniet juridike që sigurojnë rregullshmërinë dhe sigurinë e transportit dhe qarkullimit rrugor, të mbrojtura posaçërisht nga legjislacioni penal nga veprimet ose mosveprimet kriminale, si dhe faktin që kjo vepër dënohet me burgim deri në tre vjet si dhe pasojat që kjo vepër sjell.
2. Rrezikshmërinë e autorit i cili rezultoi me gjendje gjyqësore i padënuar dhe rrethanat që lidhen me gjendjen sociale e shoqërore të tij.
3. Rrethanat lehtësuese. Bazuar në nenin 48/ç të K.Penal, faktin se i pandehuri tregoi në gjykim pendim të thellë dhe bazuar në nenin 49 të K.Penal, gjykata çmon si rrethanë lehtësuese faktin se i pandehuri nuk është përsëritës, ai rezultoi të jetë i padënuar më parë dhe në gjykim ai e pranoi fajësinë.
4. Formën e fajit, i pandehuri e ka kryer veprën me dashje direkte.

Lidhur me masën e dënimit me burgim që duhet të caktohet ndaj të pandehurit, në një vlerësim të hollësishëm të rrethanave të mësipërme të çështjes të analizuarra prej saj, dhënia e masës së dënimit me burgim çmohet nga Gjykata se do të realizojë



njëkohësisht jo vetëm qëllimin e ndëshkimit të të pandehurit për veprën penale të kryer, por edhe atë të rehabilitimit, edukimit dhe riintegritimit të të pandehurit në të ardhmen në shoqëri, ku e shikon të përshtatshme dhe me vend zbatimin e nenit 63 të K.Penal, mase kjo e kërkuar edhe nga organi i akuzes.

Gjykata çmon se për shkak të rrezikshmërisë së paket që paraqet i pandehuri, plotësohen kriteret ligjore për pezullimin e ekzekutimit të vendimit të dënimit me burgim dhe detyrimin e të pandehurit për kryerjen e një pune në interes publik, të parashikuar në nenin 63 të K.Penal, i cili sanksionon:

“Gjykata, për shkak të rrezikshmërisë së paket të personit dhe të rrethanave të kryerjes se veprës penale, kur ka caktuar një dënim gjër në një vit burgim, mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit të vendimit me burgim dhe zëvendësimin e tij me detyrimin që i dënuari të përmbushë një punë në interes publik.

-Puna me interes publik nënkupton kryerjen nga i dënuari të një pune, me pëlqimin e tij dhe pa shpërblim, në favor të interesit publik apo shoqates se caktuar në vendimin e gjyqates, për një kohë nga dyzet deri në dyqind e dyzet orë.

-Ky detyrim nuk mund të vendoset kur i dënuari refuzon pezullimin në seancë gjyqësore.

-Puna në interes publik kryhet brenda afatit prej gjashtë muajsh.

-Në vendimin e saj Gjykata përcakton numrin e orëve të punës dhe detyrimin që i dënuari të mbajë kontakte me Shërbimin e Provës. Shërbimi i Provës vendos llojin e punës që do të kryhet, përcakton vendin e kryerjes së punës dhe ditët e javës kur do të kryhet ajo, duke pasur parasysh, për aq sa është e mundur, punësimin e rregullt të të dënuarit apo detyrimet e tij familjare.

-Kohezgjatja e punës me interes publik nuk i kalon tetë orë në ditë.

-Nese i dënuari nuk kryen punën me interes publik, nuk mban kontakte me shërbimin e provës apo shkel kushtet ose detyrimet e tjera, të vendosura nga gjykata, prokurori informon menjehere gjykatën. Gjykata, në kete rast, vendos sipas nenit 62 të këtij Kodi”.

Pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënia në provë e autorit të veprës penale përfshihet në kategorinë e alternativave të dënimit me burgim dhe synon të zgjerojë mundësitë e edukimit dhe rehabilitimit në shoqëri të personit që ka kryer veprën penale në formë të ndryshme nga ajo e kufizimit të lirisë së tij personale. Në rastin konkret, Gjykata çmon se riedukimi i të pandehurit mund të realizohet pa qënë e nevojshme që ai të izolohet nga shoqëria.

Në mbështetje të nenit 389 të K.Pr.Penale deklarohet heqja e masës së sigurimit “Detyrim për paraqitje në policinë gjyqësore” të parashikuar nga neni 234 i K.Pr.Penale dhe me vendimin Nr.2789 Akti, datë 15.12.2017 nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tirane.

Për sa i përket shpenzimeve gjyqësore ato duhet të ngarkohen të pandehurit, pasi atij i referohet dënimi në zbatim të nenit 393 K.Pr.Penale.

Për sa u analizua u provua me pretendimet e palëve në séance e provat shkresore të ndodhura ne dosje pjese perberese e pandare e fashikullit gjyqesore.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Në vështrim të neneve 379, 390, 403 e 406 të K.Pr.Penale dhe nenit 291 të Kodit Penal, Gjykata:

### **V E N D O S I:**

- Deklarimin fajtor të të pandehurit Hasan Shaqir Bara,për veprën penale “Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt”, të parashikuar nga neni 291 të Kodit Penal dhe dënimin e tij, me 1 (nje) muaj burgim.
- Në zbatim të nenit 406/1 të K.Pr.Penale, i zbritet 1/3 e dënimit, duke e dënuar përfundimisht të pandehurinHasan Shaqir Bara, me 20 (njetzet) dite burgim.
- Në zbatim të nenit 63 të K.Penal, pezullohet ekzekutimi i dënimit me burgim dhe zëvendësimin e tij, me detyrimin e të pandehurit për të kryer 40( dyzete) orë pune në interes publik.
- Detyrohet i pandehuri te mbaje kontakte me Zyren Vendore te Sherbimit te Proves Tirane.
- Heqjen e mases se sigurimit “Detyrim per paraqitje ne policine gjyqesore”te parashikuar nga neni 234 i K.Pr.Penale dhene me vendimin Nr.2789 Akti ,date 15.12.2017 nga Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane.
- Shpenzimet proceduriale të fazës së hetimit paraprak si dhe shpenzimet gjyqësore i ngarkohen të pandehurit.
- Kunder vendimit mund te behet ankim nga palet brenda 15(pesembedhjete) diteve ne Gjykatën e Apelit Tirane duke filluar ky afat nga e nesërmja e shpalljes se këtij vendimi.
- U shpall ne Tirane sot me date 23.04.2018 .

**SEKRETARE**  
**ORNELA BALLA**

**GJYQTAR**  
**ARTAN GJERMËNI**